

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

**Prof. Dr. Hubert Hasenauer
drejtoi misionin**

Nën udhëheqjen e tij, grupi nga Vjena ndau ekspertizën me profesorët dhe drejtuesit e UBT.

**Misioni i 18-të UBT-BOKU:
Programet e reja Master**

Misioni u vlerësua si një proces i suksesshëm nga rektori i UBT-së Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Prof. Dr. Hubert Hasenauer në rrugën e konsolidimit të UBT-së si institucion akademik me profil gjithnjë e më të fortë ndërkombëtar. **Vijon në faqen pasardhëse...**

Workshopi 3-ditor për programet Master

Dita e parë filloi me punën e përbashkët për finalizimin e programeve të reja Master dhe tre programet e mbetura Bachelor. Grupet e punës prezantuan programet e reja të studimit të ndërtuara sipas modelit të BOKU, duke përfshirë fusha si inxhinieri ushqimore, menaxhim ekosistmesh pyjore, zhvillim rural etj.

Lexo më shumë...



Petra Winter, Presidente e EAVE mori pjesë në sesionet e zhvilluara për ristrukturimin e programit Mjekësi Veterinare.



Në ditën e dytë puna vijoi në disa sesione paralele, ku u prezantuan programe të reja Master, nga Agronomia dhe deri tek Menaxhimi i Ujërave. **Lexo më shumë...**

Ditën e tretë u nxorr në pah progresi i bërë në finalizimin dhe rishikimin e programeve të reja Bachelor e Master.

Lexo më shumë...





Kërkimi shkencor në UBT: Fokus në drejtim të inovacionit në shkencat e jetës dhe teknologji

Kërkimi shkencor në UBT, nëpërmjet bashkëpunimit midis Universitetit të Barit "Aldo Moro", Departamenti i Mjekësisë Precize dhe Regenerative dhe i Zonës Joniane – DIMEPRE-J, përmes programit të Doktoraturave të përbashkëta, ka arritur që të bëjë hulumtime shkencore në fushën e terapisë së indeve të buta.

Nxitja e qelizave staminale në rigjenerimin e indeve është një fushë kyçe e mjekësisë rigjeneruese dhe biologjisë qelizore.

Kjo metodë inovative e aplikueshme sot në qasjen "Një Shëndet" ka për synim rigjenerimin e indeve të buta në njerëz dhe në kafshë nëpërmjet metodave inovative.



Kjo metodologji synon të aplikohet si në mjekësi veterinarë ashtu edhe në mjekësi humane nëpërmjet ekselencës shkencore të Departamentit të Mjekësisë Precize dhe Regenerative dhe të Zonës Joniane – DIMEPRE-J, për rigjenerimin e indeve të tendinave të muskujve, të neuroneve, të fijeve nervore, si edhe të qelizave të miokardit.



*Mirënjohje dhe vlerësim për **Profesor Antonio Crovace**, Departamenti i Mjekësisë Precize dhe Regenerative dhe i Zonës Joniane – DIMEPRE-J.*

Falënderime të veçanta për doktorantët Bledar Goxhaj dhe Taulant Goga, për përkushtimin dhe kontributin e tyre të çmuar, ndërsa po përfundojnë me sukses doktoraturat në këtë fushë, nën udhëheqjen e përbashkët të Prof. Dr. Erinda Lika, Zv. Rektore për Shkencën dhe Projektet në UBT, dhe Prof. Antonio Crovace. **Lexo më shumë...**





Mjekësia Veterinare në UBT po hyn në një fazë të re modernizimi

Universiteti Bujqësor i Tiranës, përmes Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, ka ndërmarrë një reformë të thellë të kurrikulës, duke e përafruar arsimin veterinar me standardet evropiane dhe kërkesat e profesionit të së ardhmes.

Përmes një vlerësimi të gjerë, konsultimeve ndërkombëtare dhe bashkëpunimit me Universitetin BOKU dhe ekspertët e EAEVE, Fakulteti ka dizajnuar një kurrikulë moderne, e orientuar drejt së ardhmes dhe e ndjeshme ndaj kontekstit, që përgjigjet si ndaj prioriteteve kombëtare, ashtu edhe ndaj pritshmërive më të gjera evropiane.

Në veçanti, kurrikula merr parasysh rekomandimet që dalin nga procesi i aderimit të Bashkimit Evropian, duke adresuar prioritetet kryesore për sektorin veterinar si: shëndeti publik, siguria ushqimore, rezistenca ndaj antibiotikëve, mirëqenia e kafshëve dhe forcimi i shërbimeve veterinare.

Lexo më shumë...

Workshop për Reformën Administrative, UBT-BOKU 2030

Universiteti Bujqësor i Tiranës zhvilloi një workshop strategjik tre-ditor, i fokusuar në analizën dhe modernizimin e administrimit universitar, në kuadër të Projektit UBT-BOKU 2030.

Workshop-i kishte synim forcimin e kapaciteteve administrative, përmirësimin e proceseve të brendshme dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve dhe stafit akademik, duke u mbështetur në praktikat më të mira evropiane dhe eksperiencën e Universitetit BOKU të Vjenës.

Gjatë punimeve, përfaqësues të administratës universitare, stafit akademik dhe institucioneve partnere diskutuan reforma konkrete që synojnë rritjen e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së qeverisjes universitare.

Projekti UBT-BOKU 2030 mbështetet financiarisht nga Qeveria e Shqipërisë dhe Qeveria e Austrisë.





103 vite Shërbim Pyjor Shqiptar: UBT bashkon ekspertë, studentë, me pjesëmarrjen e Ministrit të Mjedisit

Universiteti Bujqësor i Tiranës, përmes Fakultetit të Shkencave Pyjore, mblodhi ekspertë të fushës me kontribute të rëndësishme në menaxhimin e pyjeve, pedagogë dhe studentë, në kuadër të shënimit të 103-vjetorit të Shërbimit Pyjor Shqiptar. Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe Ministri i Mjedisit, Z. Sofjan Jaupaj, i cili vlerësoi rolin e institucioneve akademike në forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe në hartimin e politikave afatgjata për mbrojtjen e pyjeve.

Lexo më shumë...



Studentët e UBT zhvillojnë praktikë mësimore në terren

Studentët e vitit II dhe III Bachelor në programet Inxhinieri Agromjedisit dhe Menaxhimi i Burimeve Natyrore zhvilluan një praktikë mësimore në terren. Fokusi ishte ndikimet mjedisore të veprimtarisë industriale dhe zbatimin e standardeve ligjore. Gjatë vizitës në kompaninë Titan Albania, studentët u njohën nga afër me proceset e prodhimit, masat për mbrojtjen e mjedisit dhe praktikat e menaxhimit mjedisor në industrinë e çimentos.

Lexo më shumë...





OPEN DAYS/ Maturantë nga dy shkolla në Tiranë njihen me programet e UBT

UBT organizoi takime informuese me maturantë nga Tirana me qëllim prezantimin e ofertës studimore dhe orientimin e tyre drejt arsimit universitar me standarte europiane.

Aktivitete sportive/ Kampionati Universitar i Volejbollit për femra dhe meshkuj

Universiteti Bujqësor i Tiranës u bë pjesë e Kampionatit Universitar të Volejbollit për femra dhe meshkuj, i cili nisi me ceremoninë e hapjes në Pallatin e Sportit "Farie Hoti". Kampionati u zhvillua në datat 14 dhe 15 janar 2026. UBT mori pjesë në këtë aktivitet sportiv universitar, duke promovuar frymën e garës, sportivitetin dhe bashkëpunimin ndëruniversitar.

Suksese ekipeve tona në ndeshjet në vazhdim...



U prezantuan 13 programe Bachelor të hartuara në bashkëpunim me BOKU të cilat bazohen në kurrikula të unifikuara dhe standarde akademike të një prej universiteteve më prestigjioze në Austri dhe Evropë.

Lexo më shumë...

